

Biografia



Zonja Behide Hasanaj u lind më 20 Prill 1958 në Pejë, nga babai Mustafë Adem Hasanaj dhe nëna Shkurte Hasanaj Begolli. Shkollën fillore e kreu në vendlindje në vitet 1964-1972. Pas shkollës fillore, në vitin 1975 ajo nisi një kurs rrobaqepësie duke e ushtruar këtë profesion për disa vite. Në vitet '80, ajo shkoi në Sarajevë, ku nisi të punojë si rrobaqepëse në një jetimore dhe ku mesoi gjuhën kroate. Në vitin 1983, Znj. Behide Hasanaj emigroi në Zvicër, ku menjëherë nisi misionin vullnetar në Shoqatat bamirëse “Nëna Terezë” dhe “Kryqi i Kuq”. Po atë vit, ajo përfundoi kursin e gjuhës gjermane për nivelet më të larta. Në këtë mënyrë nisi veprimtaria e saj humanitare, fillimisht si përkthyes e shoqatës në komunat zvicerane. Ajo ishte shumë e aftë të përkthente nga gjermanishtja në kroatisht dhe anasjelltas si dhe nga shqipja në gjermanisht dhe anasjelltas. Roli i saj si përkthyes në shoqatë ka qenë thelbësor për refugjatët kroatë, boshnjakë dhe shqiptarë, të cilët u larguan me dhunë nga tokat e tyre. Zonja Behide Hasanaj gjithashtu kontribuoi në strehimin e shumë refugjatëve në Zvicër. Gjithashtu, Zonja Behide Hasanaj kontribuoi në strehimin e shumë refugjatëve në të gjithë Zvicrën.

Në vitin 1986, filloj punën në firmën “Neprenteknikerin Spezjalistin” krahas rolit si mbikqyrëse në shoqatë, ajo iu rikthye sërish profesionit të parë si rrobaqepëse për qepjen e rrobave të policisë dhe ushtrisë për shtetin zviceran. Në vitin 1991, ajo përfundoi kursin për mirëmbajtjen e dhomave dhe punoi si mbikqyrëse e stafit të punëtorëve në kompanin “Wetrok“. Ajo nisi punën në hotelin e seminareve që mbaheshin nga shtetet evropiane. Në vitin 1992 ajo përfundoi një studim si ndihmëse për njerëzit me aftësi të kufizuar dhe sëmundje mendore në Bern dhe Thun, duke iu ardhur në ndihmë shumë njerëzve në nevojë. Në vitin 1997, nisi punën në mënyrë vullnetare në spitalin shtetëror si ndihmëse mjeku për njerëzit me nevoja të veçanta. Aktiviteti i Zonjës Behide Hasanaj në Shoqatën bamirëse dega “Nëna Terezë” në Thun vijoi për vite të tëra në mënyrë vullnetare, ku gjate luftës në Kosovë, ajo ndihmoi mijëra refugjatë, të cilët merrnin rrugën e gjatë të emigrimit. Ajo i ndihmoi refugjatët për strehim dhe përbushjen e nevojave të tyre urgjente përgjatë qëndrimit në Zvicër. Puna dhe kontributi i saj i vrullshëm nisi në këtë periudhë. Krahas të ardhurave të saja vetanake, ajo mori iniciativë dhe trokiti në shumë dyer duke bërë apel në çdo cep të shtetit zviceran e mbar botën për të mbledhur fonde për të ndihmuar njerëzit që ishin dëbuar nga Kosova.

Për shtetndërtimin pas luftë ajo i bëri thirrje të gjithë bashkatdhetarëve dhe shtetasve zviceranë si dhe shumë organizatave, institucioneve për ndihmë dhe kontribut për popullin e Kosovës. Kur lufta në Kosovë kishte shpërthyer, në vitin 1997-1998, ajo mori guximin dhe me dashurinë ndaj atdheut, si koordinatorë për gjuhë Gjermane për Zvicër dhe Kosovë beri transportin dhe mbikqyrjen e ndihmavë për Kosovë të shoqatës “Nënë Terezë” dhe bëri që të gjithë të ngriheshin në këmbë dhe të ndihmonin popullin e Kosovës.

Takimet dhe vetëbesimi i saj patën sukses shumë të madh në mbledhjen e fondeve si para lufte ashtu edhe pas luftës për Kosovë. Zonja Behide Hasanaj nuk ndaloi veprimtarinë, vullnetin dhe ndihmën e saj. Ajo bëri si gjithmonë thirrje dhe apel për ndihmë dhe kontribute. Në vitin 2000, për shtetndërtimin ajo nisi vizita të njëpasnjëshme në Kosovë, për t’i dalë në ndihmë popullit, ku për një kohë shumë të shkurtër ajo se bashku edhe me shumë humanistë zviceranë arriti që të ndihmojë shumë qytete dhe fshatra të cilat ishin të prekura nga lufta. Vullneti i saj për punë ishte shumë i madh.

Në vitin 2002, Zonja Behide Hasanaj themeloi firmen “FPA-Planung GMBH”, me qëllim për të ndihmuar emigrantët kosovarë me sigurime financiare në Zvicër. Gjithashtu ajo iu ofroi ndihmë familjarëve të viktimave të pasluftës për qëndrim dhe strehim në Zvicër. Zonja Behide Hasanaj ka kontribuar në ndërtimin e spitaleve në Kosovë dhe i ka ardhur në ndihmë njerëzve me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të prekur nga lufta. Ajo mori shumë mirënjohje nëpër vendet e ndryshme si në atdhe ashtu edhe jashtë tij, gjë që e bënë ate një figure shumë të madhe dhe shumë të vlerësuar nga populli i saj.

Gjatë kësaj kohe ajo ka vazhduar me humanizmin e saj duke udhëtuar shpesh në vendlindje për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Ajo u erdhi në ndihmë shumë femrave që kishin qenë viktimat të dhunës gjatë luftës në Kosovë dhe që ishin në varfëri të skajshme, duke i ndihmuar me medikamente, ushqime, veshmbathje, etj. Ajo gjithashtu u erdhi në ndihmë edhe fëmijëve jetim që jetonin në varfëri pas plagëve të marra gjatë luftës në Kosovë. Në Maj të vitit 2013 ajo kërkoi nga populli i Kosovës dhe populli Zviceran, që të ndihmonin nënat dhe motrat të cilat ishin viktimat të dhunës gjatë luftës në Kosovë që me ndihmën e tyre të zbusnin dhimbjen e tyre, të ndihmonin fëmijët e dëshmorëve dhe familjet që jetonin në skamje. Si rezultat i këtij kontributi, besimi dhe shkathtësie, Zonja Behide Hasanaj dekorohet me mirënjohje dhe falënderim për punën e saj të zellshme dhe përpikëri në shoqatë.

Në vitin 2013, Zonja Behide Hasanaj pasurinë që kishte në Kosovë, e shiti dhe paratë ua dhuroi fëmijëve jetimë dhe atyre në gjendje jo të mirë shëndetësore. Ajo ende vazhdon pa u ndalur të kontribuojë dhe organizojë ndihma të njëpasnjëshme për të gjithë popujt. Zonja Behide Hasanaj është ndër të parat që ndihmoi popullatën shqiptare dhe kontribuoi në mënyrë të palodhshme, fakt ky i cili do të mbetet gjithmonë në zemrat dhe kujtimet e shumë njerëzve, të cilët e kanë takuar personalisht dhe patën mundësinë që të jenë pjesë e ndihmës së saj më të madhe.

Zonja Behide Hasanaj

Adresa në Zvicër

E-Mail : behide-12@hotmail.com

Datëlindja: 20.04.1958

Vendlindja: Pejë

- Gjendja familjare:

Nënë e dy fëmijëve (të rritur dhe të martuar).

- Njohja e gjuhëve:

Gjuha amtare shqipe, gjermanisht dhe kroatisht.

- Të dhënat për përgatitjen shkollore:

Shkolla 8-vjeçare, Pejë 1964-1972.

Shkolla dhe Kurse të kryera në Zvicër:

1. Kreatore e rrobave të nuserisë në vitin 1975.
2. Disajnere dhe modeliste e rrobave ushtarake dhe policore për zhytje.
3. Kursin e gjuhës gjermane, nivelet e para me program gjatë orarit të punës (pa shkëputje nga puna e përditshme).
4. Kurs për Kryqin e Kuq në vitin 1991.
5. Kurs për pastrim-Wetrok në vitin 1991.
6. Kurs për ndihmë për njerëzit me aftësi të kufizuara në vitin 1993.
7. Kursin për njerëzit me aftësi të kufizuara –mobilizimin dhe ndihmën ndaj tyre në vitin 1997.
8. Shkollën për sigurime, financa dhe hipotekë në vitet 1996-2001.
9. Shkollën për udhëheqëse e pavarur dhe përgjegjëse për sigurime dhe ndërmjetsuese bankare.

- Përvoja në punë:

Nga viti 1980-1983, si Kreatore dhe Dizenjuese.

Nga viti 1987-2006, si Përkthyes nga gjuha gjermane në shqip, kroatisht dhe anasjelltas. Falas në bazë vullnetare - pa pagesë sipas kërkesës dhe nevojës.

- Puna në Zvicër:

Ka kryer 22 vite punë të ndryshme sipas përgatitjeve dhe kurseve të lartpërmendura.

- Aktivitete të ndryshme:

1. Në vitin 1980 në Sarajevë si pronare e rrobaqepsisë, duke punuar falas.
2. Më 1984 si kreatore në Zvicër.
3. Në vitin 1986 si kreatore e Specializuar për Rroba zhytjeje.
4. Në vitin 1989 si përgjegjëse e punëtorve të pastrimit në Spital.
5. Në vitin 1991 ka punuar në shtëpinë e Seminarëve që realizoheshin nga Shtetet Evropiane si përgjegjëse e punëtorëve të Pastrimit të Dhomave.

- Jetëshkrimi, aktivitete të ndryshme bamirësie:

Nga viti 1993-2012, ka ndihmuar në përkthime dhe koordinimin e veprimtarive bamirëse në Shoqatën “Nëna Terezë“ në degët e veprimtarisë në Gjenevë, Bern, Zyrih, Luzern, Thun, etj. Gjithashtu ka kontribuar në asistimin e organizatave bamirëse ndërkombëtare me përkthim nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe në Kosovë.

Në vitin 1992, ka punuar si përkthyes dhe punëtorë sociale në “Kryqin e Kuq”, si përkthyes dhe Mbikqyrëse e Refugjateve jashtë orarit të punës (vullnetare).

Në vitin 1994, ka punuar si ndihmëse e mjekut.

Në vitin 2001, u bë pronare e kompanisë "FPA-Financial Planung GmbH".

Si shenjë falënderimi për shtetin zviceran dhe për tërë botën civilizuese, botoj librin "Një jetë veprimtari humanitare" dhe filmin "Në rrugën e shenjtërimit" si një falënderim për ndihmën që e bënë Kosovën shtet sovran dhe për ndihmën për t'i treguar botës që shqiptari di të marrë, por di edhe të falënderojë.

Gjuhë gjermane me shkrim 6 muaj, në 2017.

Kursi kundër urrejtjes në rrjetet sociale.

Kursi kundër keqpërdorimeve nëpërmjet rrjetëve sociale.

Mbrojtja e viktimave, si të mbrohen.

Më 11.05.2019, Zonja Behide Hasanaj, botoj librin “Libri i paqës” i cili u dedikohet brezave të ardhshëm.

16.06.2019. Vullnetare, 4 ditë e netë pa u ndal, duke shkruar, e duke numruar, me emra e mbiemra, disa edhe pa emra, për njëzëritë e përvuajtur që kanë vdekur ose zhdukur nëpër kufij, detra, anije, për azil të kërkuar në Zvicër, vdiqën, u zhdukën, pa ngrënë, pa pirë, pa shpresë, në detra, lumenj, kafshët duke iu ngrënë gjymtyrë, që u dëbuan nga vendët e tyre prej (1993) 35.597 deri 16.06.2019 dhe po vazhdojnë kështu në Kishën e Paqës “Heiliggeistkirche” Bern, së bashku me priftin Andreas Nufer “Njeriu i Paqës”.

Veprimtaria humanitare e Znj. Behide Hasanaj vazhdon edhe sot e kësaj dite si një urë lidhëse e bamirësisë.